



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0902

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga; Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Nika PrO- Ing” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi SHFMU në Pozharan-Komuna e Vitisë – vazhdimi i punimeve” me numër të prokurimit 214-22-8829-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, më 22/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Operatorit ekonomik, “Nika PrO- Ing” SH.P.K me nr. 2023/0902, e datës 13/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitisë – vazhdimi i punimeve”, me numër të prokurimit 214-22-8829-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Vërtetohet “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” të publikuar më datën, 26.10.2023, i Autoritetit Kontraktues, Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër: 214- 22-8829-5-1-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.08.2022 Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitisë - vazhdimi i punimeve” me nr. të prokurimit: "214-22-8829-5-1-1". Me datën 23.01.2023 AK, ka publikuar B58 Njoftimin mbi anulim të Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 939 633,44 €.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/569-579/2022 dhe PSH nr. 2023/074.

Me dt. 26.10.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e kanë rekomanduar për kontratë grupin e OE "AAG Projekt SH.P.K & AC ing SH.P.K & Euro Eervices" SH.P.K

Me datën 31.10.2023, OE "Nika Pro- Ing" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK-së të datës 26. 10. 2023.

Me 03.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "NIKA Pro- Ing SH.P.K."- Ferizaj me nr. 902/23 lidhur me aktivitetin "Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitisë - vazhdimi i punimeve" me nr. të prokurimit: "214-22-8829-5-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "NIKA Pro- Ing SH.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm sepse i njëjti nuk e ka vazhduar validitetin i cili i ka skaduar me dt. 20.10.2023 do të thotë OE i rekomanduar për kontratë në vazhdimin e fundit të validitetit të ofertës e ka bërë me dt. 20.07.2023 këto dokumente i kemi kërkuar në qasjen tonë dhe kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka pasur vazhduar validitetin në momentin e vlerësimit të ofertave. Kjo është përgjegjësi e zyrtarit të prokurimit të cilit pas disa vendimeve të OSHP që e ka shpallur te pa përgjegjshëm OE të rekomanduar për kontratë njeherit shihet qartë se i lartpërmenduri e ka bërë shkelje të mëdha ligjore pasi i ka shpallur fitues për të tretën herë OE të njëjtit, edhe pse i njëjti nuk ka pasur të vazhduar validitetin. Kërkojmë nga PSH që konform LPP-te të merr masa ligjore për konfiskimin e licencës menaxherin të prokurimit.

Pretendimi i dytë (II): OE është i pa përgjegjshëm sipas 2 vendimeve të OSHP-së të cilët PSH ka konstatuar se OE nuk ka arritë ti përmbush kriteret e kërkuara në DT...Pika a. OE nuk ka arritë të përmbush kërkesën për makineri e cila në DT ka qenë të kapaciteti teknik dhe profesional 9. I& 9.2 OE duhet të dëshmoj se posedon këto pajisje (Kërkesa e qartë dhe kërkesë e kufizuar): Greder 5.2-6.2 ton. Këtë Pajisje OE e vërteton edhe vet se nuk e posedon apo nuk ka marrëveshje me asnjë OE po në vend të kësaj kërkesë ka ofruar një pajisje me peshë me të madhe 10 ton, PSH e ka konstatuar se kërkesat në DT nuk janë të lejuar ekuivalenca, por janë kërkesa decitive.

Edhe sipas LPP-së dhe RROUP kërkesat ne DT duhet të plotësohen në përpikëri. Nëse OE ka shqetësim mundet të kërkoj në fazën e njoftimit për kontratë sqarim shtesë apo Kërkesë për rishqyrtim. OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka bërë një kërkesë të tillë. Vlen të theksohet se ju si zyre e prokurimit keni bërë kërkesë të njësia e kërkesës se a bënë të ofrohet pajisja më e madhe e cila është në kundërshtim me LPP-në dhe RROUP. Konstatimi i PSH sipas OSHP-së me nr.2023/ 0074 ne e kemi vërejtur se OE AAG nuk i plotëson kërkesat e dosjes së Tenderit. Me gjithë këtë sa i përket kërkesave të dosjes rreth makinerisë. konkretisht grederit ku maksimumi i lejuar në dosje ka qenë 5.2 deri 8 ton, OE ka ofruar dëshmi për greder 10 ton, do thotë 2 ton me shumë se pesha maksimale e caktuar nga AK. Pra nga fakti i lartcekur kuptohet qartë se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe i njëjti nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

Pretendimi i tretë (III): OE nuk ka arrite të përmbush kërkesën për staf profesional e cila ne DT ka qenë të kapaciteti teknik dhe profesional 9. I& 9.2. Një teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV dhe një ekspert për instalimin e sistemeve BMS. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson kërkesën të dosjes së tenderit, ku kërkesë ka qenë “Një teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Certifikatat - dëshminë e kualifikimi tepër CCTV - kopje , CV kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin- Kopje ". I njëjti OE për kërkesën e lartcekur në ofertë ka prezantuar dëshmi për z. Bujar Morina, por që këto dëshmi nuk janë ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që nuk është ofruar certifikata e kërkuar që e vërteton faktin se i njëjti është i kualifikuar për CCTV. Po ashtu për të njëjtin, janë prezantuar edhe disa certifikata të cilat nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe po ashtu të njëjtat certifikatat janë pa validitet, pasi që ato janë lëshuar në vitin 2020 dhe janë valide vetëm dy vite. Përveç se disa prej certifikatave të ofruara janë pa validitet, të tjerat nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit. Përderisa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar certifikatën me kualifikim CCTV, është i qartë fakti se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, sepse nuk e ka plotësuar edhe kërkesë tjetër të dosjes së tenderit “Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për instalimin e sistemeve BMS”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për instalim dhe startup të BMS - Kopje, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin kopje". I njëjti operator ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se në oferte ka prezantuar znj. Jasna Vasilevska, e cila nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, pasi që nuk figuron asnjë dëshmi se e njëjta është e certifikuar për instalimin e sistemeve BMS. Për të njëjtë nuk janë prezantuar certifikatat sipas kërkesës së lartcekur dhe si të tilla këto dëshmi nuk janë ofruar konform kërkesës së lartcekur, andaj nga ky fakt vërtetohet se i njëjti OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar disa certifikata për të njëjtën mirëpo që certifikatat e prezantuar nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit. Konstatimi i PSH me vendimin 2023/0074- Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, konstaton se AK duhet të jetë më i qartë gjatë vendosjes së specifikimeve teknike e në rastin konkret të sqaroj lidhur me kërkesën e vendosur sa i përket certifikatave CCTV dhe BMS , ofertat e ofruara nga OE ofertues a i plotësojnë kërkesat në mënyrë decidive apo janë ekuivalente për të cilat në kërkesën e vendosur në DT nuk është e lejuar ekuivalenca. Edhe ne vendimin e pare te OSHP-së 569/,579/22 PSH ka konstatuar se OE është i pa përgjegjshëm. Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues kundër GOE i rekomanduar duke pretenduar se GOE i rekomanduar nuk ka plotësuar kriteret sipas dosjes së tenderit, ku kërkesë ka qenë një teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Certifikatat dëshminë e kualifikimit për CCTV

kopje, CV kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valid me punëdhënësin-Kopje”, duke pretenduar se GOE për kërkesën e lartcekur ne ofertë ka prezantuar dëshmi për z. Bujar Morina, por që këto dëshmi nuk janë ofruar komform kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që nuk është ofruara certifikata e kërkuar që e vërteton faktin se i njëjti është i kualifikuar për CCTV, po ashtu për të njëjtin, janë prezantuar edhe disa certifikata të cilat nuk janë komform kërkesës së dosjes së tenderit dhe po ashtu të njëjtat certifikatat janë pa validitet, pasi që ato janë lëshuar në vitin 2020 dhe janë valide vetëm dy vite, përveç se disa prej certifikatave të ofruara janë pa validitet të tjerat nuk janë komform kërkesës së dosjes së tenderit, PSH pretendim ankimor e klasifikon si të bazuar për faktin se OE i rekomanduar nuk plotëson këtë kërkesë të vendosur të DT. andaj me qene se kjo dëshmi kërkohet në DT tek kapaciteti teknik dhe profesional në DT, që si të tilla janë kritere kualifikuese, andaj PSH konstaton se ky pretendim është i bazuar dhe si i tillë e bënë të papërgjegjshëm OE rekomanduar lidhur me këtë aktivitetin të prokurimit.

Prendimi i katërt (IV): Nuk pajtohem sa i përket arsyes së eliminimit tonë, ku e ka shënuar se një anëtar i konsorciumit tonë ka deklaruar se është pjesë edhe e një grupi tjetër ofertues në këtë aktivitet të prokurimit, ju sqarojmë se ky konstatim është plotësisht i pasaktë, sepse ne jemi grup i operatorëve ekonomik në përbërje prej Nika PrO-Ing SHPK & NNPT Engineering & NNP Art Projekt dhe se ky fakt vërtetohet edhe në procesverbal të hapjes së ofertave, ku figurojnë të gjithë emrat e anëtarëve të konsorciumit, ndërsa asnjëri prej këtyre anëtarëve nuk është ofertues në këtë aktivitet të prokurimit me ndonjë grup apo si ofertues individual. Nëse aludohet tek deklaratat e konsorciumit tonë, ne ju sqarojmë se tek deklarata ka ndodhe një lëshim teknik. Marrëveshja për themelimin e konsorciumit ndërmjet tre anëtarëve është e nënshkruar dhe e vulosur nga të tri palët dhe është në rregull, e ku është përcaktuar që udhëheqës i konsorciumit të jetë Nika PrO-Ing SHPK. Po ashtu edhe deklaratat individuale të anëtarëve të konsorciumit janë të nënshkruara nga secili anëtarë i grupit dhe janë në rregull, por lëshimi i vetëm teknik është tek tri deklaratat e përbashkëta, ku lëshimi është vetëm tek shënimi i emrit (në fillim ku cekën emrat), ku në vend që të jetë emri i kompanisë Nika PrO-Ing SHPK ka mbetur shabllon emri i një kompanie tjetër Global Holding Shpk, e kjo ka mbet nga bashkëpunimet e kaluara, mirëpo edhe tek këto deklarata në fund të tyre është shënuar emri saktë i Nika PrO-Ing SHPK dhe është e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i kompanisë në fjalë. Ky është vetëm një lëshim teknik sepse të gjitha deklaratat janë të nënshkruara dhe të vulosura nga të tre anëtarët e konsorciumit, kurse kur deklarata janë të paqarta sipas nenit 39 të RRUOPP-së lejohet të kërkohen sqarime edhe pse në këtë rast të gjitha deklaratat janë të nënshkruara nga të tre anëtarët e konsorciumit dhe janë në rregull sa i përket nënshkrimeve dhe vulave.

Prendimi i pestë (V): Sa i përket arsyes tjetër se kemi dorëzuar paramasë jo standarde, e cila nuk ka qenë në sistem të E prokurimit, edhe pse nuk ka ndryshim në kalkulimin e paramasës, ju sqarojmë se ky është vetëm një devijim i vogël sipas nenit 59.4 të LPP-së pika (ii) ku ceket që përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në këtë rast, AK-ja e ka cekur që nuk ndryshon kalkulimi, prandaj kjo realisht nuk ka asnjë efekt në paramasë dhe nuk ndikon absolutisht në rrethanat që oferta jonë të shpallet e papërgjegjshme, prandaj devijimet e vogla janë përcaktuar për këto raste të cilat nuk ndikojnë në substancë dhe të cilat nuk devijojnë nga kërkesat, kushtet dhe karakteristikat e përcaktuara në dosje të tenderit. Nuk pajtohem me konstatimin e tyre (komisionin vlerësues apo zyrën e prokurimit) lidhur me arsyet e eliminimit të tyre pasi konstatimi i tyre është në kundërshtim LPP-dhe RROUP. Siç shifet nga vlerësimi i parë i kësaj procedure në çdo vendim të juajin na keni eliminuar për disa pika tash për të fundit herë na keni eliminuar vetëm për dy gabim teknik për të cilën ne me dt 11.10.2022 kemi kërkuar interpretim në KRPP dhe në kërkesën e parë për

rishqyrtim ne e kemi ofruar këtë interpretim mirëpo ata nuk e kanë marrë për bazë prape, apo nuk e kanë njoftuar komisionin e vlerësimit që ekziston një interpretim, Në attach po ju përcjellim kërkesën edhe përgjigjen nga KRPP lidhur me krijimin e grupit dhe devijimin në paramasë, i cili nuk e ndryshon rezultatin. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e kemi rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm Gjithashtu ju nuk e kemi respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi I i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Po ashtu ju nuk e kemi respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Interesi i përgjithshëm i cekun edhe në vendimin e OSHP-se është natyra e punës e ndjeshme të cilët dihet që kjo zvarritje disa vjeçare e kësaj shkolle është problem për komunitetin në fshatin Pozhoran, të cilat janë duke e mbajtur mësimin në 4 ndërrime me një shkolle tjetër, kjo zvarritje është duke ndodhur nga zyra e prokurimit që dy here rresht dhe një anulim e bene për të njëjtin OE.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1- Qëllimi, nenin 7- Barazia në Trajtim/Jo diskriminimi, neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Ekzaminimi i Tenderëve, neni 60 -Kriteret për dhënie të kontratës, neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, dhe neni 72 i LPP-së.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 902/23, ndërsa me datë 19.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0902 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK”.

Lidhur me pretendimet e OE “NIKA Pro- Ing SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0902 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitisë - vazhdimi i punimeve” me nr. të prokurimit: "214-22-8829-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 25.08.2022, hapja e ofertave është bërë me datë 15.09.2022. Sqarojmë se, ky aktivitet i prokurimit ka disa rivlerësime dhe vendime nga AK dhe OSHP. Duke ju referuar vendimet e fundit nga OSHP- PSH.nr. 074/2023 të datës 25.07.2023, dhe PSH 588/2023 dt, 11.10.2023 i cili vendim aktivitetin e prokurimit e kthen në rivlerësim dhe në pikën zero të vlerësimit të ofertave. Tutje, pas rivlerësimit të ofertave nga AK, me datë 26.10.2023 i njëjti rekomandon për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik (GOE) “AAG PROJEKT SHPK & AC ing SHPK & Euro Services SHPK”, ndërsa OE ankuesin e shpallë të eliminuar. OE ankuesi ka parashtruar pretendime kundër eliminimit të tyre nga AK, si dhe kundër Grupit të Operatorëve Ekonomik (GOE) të rekomanduar.

Fillimisht sqarojmë pretendimet e GOE të rekomanduarit, në të cilën pretendimi i parë nuk ka qenë i parashtruar në kërkesën për rishqyrtim, mirëpo në ankesë është i parashtruar. Andaj konform rregullores së punës të OSHP-së nr.01/2020 neni 19.1, vazhdohet me shqyrtim.

Konstatimi i parë (I): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankues sqaron se, GOE i rekomanduar ka të bashkangjitur vlefshmërinë e ofertës me datë 16.10.2023 edhe për 60 ditë tjera, konform kërkesës së AK të parashtruar me datë 12.10.2023, si e tillë ky pretendim i OE ankuesit nuk gjendet i bazuar. Ekspertja shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues sqaron se, ky pretendim ka qenë dhe është trajtuar, ku në vendimin e fundit PSH.NR 588/2023 dt.11.10.2023, paneli shqyrtues konstaton se pas sqarimit me njësinë kërkuese, mbetet në diskrecion të AK-së.

Konstatimi i dytë (II): Ekspertja shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues sqaron se, ky pretendim ka qenë dhe është trajtuar, ku në vendimin e fundit PSH 588/2023 dt.11.10.2023, paneli shqyrtues konstaton se pas sqarimit me njësinë kërkuese, mbetet në diskrecion të AK-së.

Konstatimi i tretë (III): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e tretë sqaron se, vendimi i fundit 588/2023 dt 11.10.2023 sa konstatuar se pas sqarimeve të mbetet në diskrecion të AK-së për ta trajtuar dhe e konsideron si çështje të gjykuar.

Konstatimi i katërt (IV): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me arsyet e eliminimit të OE ankues sqaron se, ky pretendim ka qenë dhe është trajtuar me Vendimin PSH. nr.569-579/22 dt.17.01.2023.

Konstatimi i pestë (V): Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e peste sqaron se ky pretendim ka qenë dhe është trajtuar me Vendimin PSH. nr.569-579/22 dt.17.01.2023. Si përfundim, meqenëse pretendimet e OE ankues kundër GOE të rekomanduarit janë trajtuar dhe gjykuar më herët nga paneli shqyrtues, ku për të njëjtat pretendime vendimi i fundit i P.SH. nr.588/2023 dt.11.10.2023 ka konstatuar se në rivlerësim të kërkohen sqarime ku vlerësimi i sqarimeve të mbetet në përgjegjësi të autoritetit kontraktues, për të cilën AK në rivlerësim ka respektuar vendimin e lartpërmendur atëherë si e tillë, konsideroj se kjo lëndë refuzohet si e pa bazuar, dhe mbetet vendimi i AK-së në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik, Njoftimin për Kontratë, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për të shpërblyer me kontrate OE për aktivitetin e prokurimit, Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësuese të AK, Vendimin e Autoritet Kontraktues lidhur me Kërkesën për rishqyrtim.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë konstatuar si të pabazuara.

Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konsideron se ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm administrativisht dhe me çmim më të ulët, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi SHFMU në Pozharan - Komuna e Vitisë – vazhdimi i punimeve”, prokurimi me numër: 214- 22-8829-5-1-1. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit ekonomik:”NIKA PrO- Ing SH.P.K.”, dhe ka Vërtetuar Vendimin e AK -B58 të datës 26.10.2023, Autoritetit Kontraktues, Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Po ashtu vlen të theksohet se bazuar në parimet bazë të LPP konform nenit 1 dhe 6 të LPP (ekonomiciteti i shfrytëzimi të buxhetit), në këtë rast paneli shqyrtues vëren OE ankues është me çmim dukshëm më të lartë, ka ofertuar në vlerën; 939,993.07 euro, derisa sa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertuar në vlerën; 743,609.12 euro, vendimi AK-së i, datës 26.10.2023.

Në anën tjetër paneli konstaton se është përgjegjësi e Autoriteti kontraktues bazuar në nenin 59, paragrafi 4 i LPP-së, mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse përmban devijime të vogla dhe që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale, andaj paneli shqyrtues bazuar në përgjegjësit e tij në nenin 104 paragrafi 4 të LPP, vendosi, duke u bazuar në interesin të përgjithshëm dhe kategorisë së ndjeshme që aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me ndërtimin e shkollave që ndërlidhet me arsimimin e fëmijëve dhe duke marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosë po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në nenin 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE, vendosi të konfiskohet tarifa e ankësës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME, MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K., NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: